

KOCEFAN

CEFTRIAXONE
(1gr)



Kocefan është antibiotik i grupit të cefalosporinave, i gjeneratës së tretë



Ka 1g pluhur dhe 3.5ml shkrirës injektabel për përdorim intramuskular.

Bëhet vetëm një herë në ditë.

INFORMACION KLINIK

Përdoret në infeksionet e rënda bakteriale të shkaktuara nga bakteriet gram negative dhe gram pozitive. Vepron ndaj bakterieve rezistente ndaj atibiotikëve të zakonshëm. Përdoret gjithashtu në të sëmurët me rezistencë të ulët.

INDIKACIONE TERAPEUTIKE

- Infeksionet pulmonare: bronkit akut, bronkopneumoni, pneumoni, bronkit kronik i riakutizuar, astma bronkiale.
- Infeksionet e ORL: tonsilit, sinozit, mastoidit, laringiti akut.
- Infeksionet e aparatit urinar: pyelo nefrit akut dhe kronik, cystitis, prostatitis, etj.
- Infeksione të tjera: encefalitis, meningitis, osteomyelitis, pyodermatitis sepsis, etj.
- Profilaksi të plagëve kirurgjikale

Është antibiotiku më i lirë i grupit të vet

KUNDËRINDIKIMET

- Hipersensibilitet nga cefalosporinat apo nga ndonjë nga përberësit e saj.
- Në rastet e hiperndjeshërisë nga penisilina duhet pasur parasysh shfaqja e ndonjë alergjie të kryqëzuar.
- Në gratë shtatëzëna dhe me fëmijë në gji përdoret vetëm në rastet e domosdoshme, nën kujdesin direkt të mjekut.

EFEKTET ANËSORE

- Shqetësime gastrointestinale: diarre, të përziejera, të vjella, stomatite.
- Ndryshimet hematologjike: eosinofilia, leucopenia, granulocitopenia, anemia, trombocitopenia.
- Reaksione të lëkurës: ekzantema, dermatit alergjik, të kruajtura, urtikaria dhe edema.
- Efekte të tjera anësore të rralla: dhimje të lehta të kokës, marrje mendsh, rritje të transaminazave, kandidoza vaginale, ethe, temperaturë dhe reaksionet anafilaktike. Shfaqja e shokut anafilaktik është shumë e rrallë.

DOZIMI DHE MËNYRA E PËRDORIMIT

Të rritur dhe fëmijë mbi 12 vjeç: doza e këshilluar është 1g KOCEFAN një herë në ditë (çdo 24 orë). Në rastet më të rënda apo në infeksionet e shkaktuara nga mikroorganizmat e ndjeshëm doza mund të shkojë deri në 4g në një përdorim të vetëm.

Neonatët (deri 2 javësh): doza ditore është 20-50 mg/kg për peshë trupore për një përdorim të vetëm. Për shkak se sistemi enzimatik nuk është i maturuar nuk duhen kaluar 50mg/kg.

Fëmijë (nga 3 javësh deri 12 vjeç): doza ditore mund të variojë nga 20 në 80 mg/kg.

Për fëmijët me peshë trupore 50kg do të përdoret doza e të rriturve.

Të moshuarit: skema e dozimit të të rriturve nuk modifikohet për rastet e pacientëve të moshuar.

Zgjatja e terapisë është në funksion të dekursit të infeksionit. Si të gjithë terapitë me antibiotik, në përgjithësi përdorimi i KOCEFAN vazhdon minimalisht deri 48-72 orë mbas largimit të temperaturës.

VEÇORITË FARMACEUTIKE

- Ceftriaxoni ushtron veprimin e tij antibakterial nëpërmjet bllokimit të enzimave bakteriale të veçanta që marrin pjesë në sintezën e murit qelizor të qelizës bakteriale.
- Është antibiotik që vepron mbi bakteriet gram pozitiv dhe gram negative aerobe.
- Vepron dhe në bakteriet anaerobe.
- Është antibiotik që vepron një herë në ditë.
- Nuk metabolizohet në organizëm dhe eliminohet në mënyrë aktive respektivisht 56% nga veshka dhe 44% nga mëlçia. Eliminimi në veshkë bëhet nëpërmjet filtrimit në glomerula.
- KOCEFAN nuk mund të përziejhet në shiringë me medikamente të tjera, por duhet përdorur veçantë.
- Tretësira e përgatitur mund të ruhet në kushte frigoriferike deri në 24 orë.